



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1913/ 7 prot.

Datë 13/08/2024

V E N D I M
Nr. 1036/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13/08/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AEK MUNELLA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12492-07-09-2024, me objekt “Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12492-07-09-2024, me objekt “Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “AEK MUNELLA” SHPK me NIPT: J98926001P dhe me adresë: Lagjja "Gjakez"

ndërtesë me nr. pasurie 40, zona kadastrale 1717, Fan, Mirditë, Lezhë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Mirditë
Adresa: Sheshi "Abat Doci", Rrëshen.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar,.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.07.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. *REF-12492-07-09-2024*, me objekt “*Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite*”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

II.2. Në datën 12.07.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/4321 dhe me nr. 1913/2024 prot., datë 15.07.2024 e operatorit ekonomik “*AEK MUNELLA*” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Përmes shkresës pa datë protokolluar me tonën me nr. 1913/2/2 prot., datë 29.07.2024 autoriteti kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike dërguar më datë 29.07.2024, si dhe me shkresën nr. 2060/10 prot, datë 30.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1913/3 prot, datë 31.07.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar vendimmarrjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave me vendimin nr. 30, datë 29.07.2024, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nga ku rezulton se ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“NË LIDHJE ME KËRKESËN 1:

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

2.3.2/2 Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

Ankimuesi ankimon për ndryshimin, duke e hequr inxhinierin gjeolog.

SHQYRTIM I KËRKESËS 1:

Në lidhje me këtë kërkesë KSHA e pranon ankimin i OE, duke e hequr nga kërkesat për kualifikim inxhinierin gjeolog.

NË LIDHJE ME KËRKESËN 3:

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si më poshtë::

Teknik i mesëm ndërtimi	2 (dy)
Teknik i mesëm gjeodet/topograf	1 (një)
Karpentier	2 (dy)
Specialist për punime betoni (betonues)	1 (një)
Specialist për punime asfalti	4 (katër)
Eskavatorist	2 (dy)
Automakinist	2 (dy)
Buldozerist	2 (dy)
Shofer	6 (gjashtë)

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;
- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhen e kerkuar.
- Dokument (diplomë/certifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Për tekniket duhet të deklarojnë dhe paraqiten diplome e shkolles se mesme teknike ndersa Për punonjësit Eskavatorist/Automakinist/Buldozerist/Shofer të paraqiten leje drejtimi, certifikate e aftësi profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).

Per te gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punës; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatin e vlefshmerise se saj; numrin e diplomës/certifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimin nga DPSHTRR dhe afatin e vlefshmerise se saj si edhe autoritetin leshues te saj shoqeruar me niptin perkates kur keto autoritete jane private.

Ankimuesi ankimon për ndryshimin, duke ulur nga 2 në 1 numrin e teknikëve të mesëm të ndërtimit dhe zvogëlimin e numrit të specialistëve të tjerë të kërkuar (pa specifikuar se si).

SHQYRTIM I KËRKESËS 3:

Në lidhje me këtë kërkesë, duke qënë se operatori ekonomik nuk e ka specifikuar se çfarë ndryshimesh kërkon apo i konsideron diskriminuese, atëherë KSHA e konsideron të pranuar ankimin e OE, duke e rishikuar dhe kryer ndryshimet e këtij kriteri si vijon:

Teknik i mesëm ndërtimi	1 (nje)
Teknik i mesëm gjeodet/topograf	1 (një)
Karpiertier	1 (një)
Specialist per punime betoni (betonues)	1 (një)
Specialist/puntor per punime asfaltimi ne rruge	2 (dy)
Eskavatorist	1 (një)
Automakinist	1 (një)
Buldozerist	1 (një)
Shofer	2 (dy)

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;
- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhen e kerkuar.
- Dokument (diplomë/certifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Per tekniket duhet te deklarohen dhe paraqitet diplome e shkolles se mesme teknike ndersa Për punonjesit Eskavatorist/Automakinist/Buldozerist/Shofer te paraqiten leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).

Per te gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punes; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatin e vlefshmerise se saj; numrin e diplomës/certifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimin nga DPSHTRR dhe afatin e vlefshmerise se saj si edhe autoritetin leshues te saj shoqeruar me niptin perkates kur keto autoritete jane private.

NË LIDHJE ME KËRKESËN 4:

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 6
2	Kamionçinë vetëshkarkuese	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion me vinç të integruar	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autogreider me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Autopompë betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1

12	<i>Eskavatorë me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Rul gomë-hekur mbi 15 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
14	<i>Rul gomë-hekur mbi 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
15	<i>Rul hekur-hekur mbi 7 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
16	<i>Rul gome-gome mbi 7 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
17	<i>Rul hekur-hekur i vogel 2-4 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
18	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
19	<i>Autobitumatrice</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
20	<i>Vibratorë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
21	<i>Minieskavatorë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
22	<i>Minifadromë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
23	<i>Aparat topografik GPS</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
24	<i>Total station</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
25	<i>Deflektometer</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
26	<i>Fabrikë asfaltobetoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
27	<i>Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
28	<i>Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
29	<i>Makineri vizimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
30	<i>Tabela sinjalizuese kantjeri</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 10</i>
31	<i>Kaska/kokore</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 25</i>
32	<i>Jeleke kantjeri</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 25</i>
33	<i>Komplet i ndihmes shpejte</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>

Ankimuesi ankimon citoj fragment nga ankesa...

Dhe kjo pikë e DST mendojmë se nuk është në përputhje me nenin 36 të LPP dhe VKM-së për arsye se makineritë që kërkohen nuk janë në përputhje me punimet që kërkohen të kryhen. Makineria që kërkohet janë të mbikërkua dhe në kalim të absurdite. Këto makineri nuk kanë si të kërkohen se janë të papërshtatshme për këtë objekt.

Makineritë e sipërkërkua nuk janë në përputhje me LPP dhe VKM-në. Nga nr. 1 deri në nr. 33 makineritë janë kërkuar jashtë asaj që mund të duhet.

SHQYRTIM I KËRKESËS 4:

OE nuk përcakton se cila makineri konkrete nuk është përcaktuar sipas ligjit, pavarësisht kësaj, kërkesa e OE do të konsiderohet e pranuar dhe bëhen ndryshimet si vijon:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
2	<i>Kamionçinë vetëshkarkuese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
3	<i>Fadromë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
4	<i>Autogreider me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

5	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Eskavatorë me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Rul gomë-hekur mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Rul hekur-hekur mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Rul gome-gome mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rul hekur-hekur i vogel 2-4 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Vibratorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Minieskavatorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Minifadromë	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Fabrikë asfaltobetoni (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
20	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodit III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
21	Makineri vizimi	në pronësi ose me qira	Copë 1

NË PËRFUDIM VENDOSA:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së Operatorit Ekonomik AEK MUNELLA Shpk, sipas konstatimeve të mësipërme.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “AEK MUNELLA” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, dhe konkretisht për sa i përket kërkesës nr. 1, kërkesës nr. 3 dhe kërkesës nr. 4, të parashtruara në formularin e ankesës të ankimit elektronik me nr. A/2023/4321, datë 12.07.2024 dhe me nr. 1913/2024 prot., datë 15.07.2024, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës pa datë protokolluar me tonën me nr. 1913/2/2 prot., datë 29.07.2024 autoriteti kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike dërguar më datë 29.07.2024, si dhe me shkresën nr. 2060/10 prot, datë 30.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1913/3 prot, datë 31.07.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar

vendimmarrjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave me vendimin nr. 30, datë 29.07.2024, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, nga ku rezulton se ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“NË LIDHJE ME KËRKESËN 1:

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

2.3.2/2 Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

Ankimuesi ankimon për ndryshimin, duke e hequr inxhinierin gjeolog.

SHQYRTIM I KËRKESËS 1:

Në lidhje me këtë kërkesë KSHA e pranon ankimin i OE, duke e hequr nga kërkesat për kualifikim inxhinierin gjeolog.

NË LIDHJE ME KËRKESËN 3:

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, si më poshtë::

<i>Teknik i mesëm ndërtimi</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Teknik i mesëm gjeodet/topograf</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Karpentier</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Specialist për punime betoni (betonues)</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Specialist për punime asfalti</i>	<i>4 (katër)</i>
<i>Eskavatorist</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Automakinist</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Buldozerist</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Shofer</i>	<i>6 (gjashtë)</i>

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;*
- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhen e kërkuar.*
- Dokument (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Për tekniket duhet të deklarohen dhe paraqitet diplome e shkolles se mesme teknike ndersa*

Për punonjesit Eskavatorist/Automakinist/Buldozerist/Shofer te paraqiten leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).

Per te gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punes; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatin e vlefshmerise se saj; numrin e diplomës/çertifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimin nga DPSHTRR dhe afatin e vlefshmerise se saj si edhe autoritetin leshues te saj shoqeruar me niptin perkates kur keto autoritete jane private.

Ankimuesi ankimon për ndryshimin, duke ulur nga 2 në 1 numrin e teknikëve të mesëm të ndërtimit dhe zvogëlimin e numrit të specialistëve të tjerë të kërkuar (pa specifikuar se si).

SHQYRTIM I KËRKESËS 3:

Në lidhje me këtë kërkesë, duke qënë se operatori ekonomik nuk e ka specifikuar se çfarë ndryshimesh kërkon apo i konsideron diskriminuese, atëherë KSHA e konsideron të pranuar ankimin e OE, duke e rishikuar dhe kryer ndryshimet e këtij kriteri si vijon:

<i>Teknik i mesëm ndërtimi</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>Teknik i mesëm gjeodet/topograf</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Karpentier</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Specialist per punime betoni (betonues)</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Specialist/puntor per punime asfaltimi ne rruge</i>	<i>2 (dy)</i>
<i>Eskavatorist</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Automakinist</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Buldozerist</i>	<i>1 (një)</i>
<i>Shofer</i>	<i>2 (dy)</i>

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontrata e punës, e vlefshme;*
- Të figurojë në Listpagesat e subjektit për periudhen e kerkuar.*
- Dokument (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional) që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, lëshuar nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Per tekniket duhet te deklarohen dhe paraqitet diplome e shkolles se mesme teknike ndersa Për punonjesit Eskavatorist/Automakinist/Buldozerist/Shofer te paraqiten leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale / Patente Manovrimi nga DPSHTRR).*

Per te gjithë stafin teknik, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë: emrin dhe mbiemrin; profesionin/profilin e punes; numrin e kontratës individuale të punës dhe afatin e vlefshmerise se saj; numrin e diplomës/çertifikatës së arsimit profesional/Patentës Manovrimin nga DPSHTRR dhe afatin e vlefshmerise se saj si edhe autoritetin leshues te saj shoqeruar me niptin perkates kur keto autoritete jane private.

NË LIDHJE ME KËRKESËN 4:

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 6
2	Kamionçinë vetëshkarkuese	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion me vinç të integruar	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autogreider me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Autopompë betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Eskavatorë me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rul gomë-hekur mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Rul gomë-hekur mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Rul hekur-hekur mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Rul gome-gome mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Rul hekur-hekur i vogël 2-4 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Vibratorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Minieskavatorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Minifadromë	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Aparat topografik GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
24	Total station	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Deflektometer	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Fabrikë asfaltbetoni (e pajisur me leje mjedisore kodë III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
27	Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodë III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
28	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodë III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
29	Makineri vizimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
30	Tabela sinjalizuese kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 10
31	Kaska/kokore	në pronësi ose me qira	Copë 25
32	Jeleke kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 25
33	Komplet i ndihmes shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 3

Ankimuesi ankimon citoj fragment nga ankesa...

Dhe kjo pikë e DST mendojmë se nuk është në përputhje me nenin 36 të LPP dhe VKM-së për arsye se makineritë që kërkohen nuk janë në përputhje me punimet që kërkohen të kryhen.

Makineria që kërkohet janë të mbikërkua dhe në kalim të absurdite. Këto makineri nuk kanë si të kërkohen se janë të papërshtatshme për këtë objekt.

Makineritë e sipërkërkua nuk janë në përputhje me LPP dhe VKM-në. Nga nr. 1 deri në nr. 33 makineritë janë kërkuar jashtë asaj që mund të duhet.

SHQYRTIM I KËRKESËS 4:

OE nuk përcakton se cila makineri konkrete nuk është përcaktuar sipas ligjit, pavarësisht kësaj, kërkesa e OE do të konsiderohet e pranuar dhe bëhen ndryshimet si vijon:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamionçinë vetëshkarkuese	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Autogreider me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Eskavatorë me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Eskavatorë me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Rul gomë-hekur mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Rul hekur-hekur mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Rul gome-gome mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rul hekur-hekur i vogël 2-4 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Vibratorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Minieskavatorë	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Minifadromë	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Fabrikë asfaltbetoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
20	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
21	Makineri vizimi	në pronësi ose me qira	Copë 1

NË PËRFUDIM VENDOSA:

2. Pranimin e pjesshëm të ankesës së Operatorit Ekonomik AEK MUNELLA Shpk, sipas konstatimeve të mësipërme.”.

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet

nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se :

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

Për këtë arsye, si dhe nisur nga fakti se operatori ekonomik ankimues në pretendimet e parashtruara në kërkesën nr. 3 dhe kërkesën nr. 4 nuk identifikon se si duhet të modifikohen kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.7 dhe pikën 2.3.8 “2.3 Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 “**FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 1913 protokollin me datë 15.07.2024 e operatorit ekonomik “**AEK MUNELLA**” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “**AEK MUNELLA**” ShPK ku kërkon: “**KËRKESA 2**

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukturë transporti)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin.

Duke shqyrtuar preventivin e sipërcituar dhe specifikimet teknike mendojmë se ky kriter është kërkuar në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

Ju vejmë në vëmendje dhe dijeni se në tre objekte që Bashkia Mirditë ka shpallur në faqen e APP-së, janë anuluar për shkak të gabimeve në përpilimin e dokumentave standart të tenderit.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 "FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT" "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.4 "Kapacitetin teknik", të dokumentave të tenderit të modifikuara nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

"2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukturë transporti)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin."

III.2.2. Në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin e zërave të punimeve objekt prokurimi si vijon:

PREVENTIVI

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION RRUGA FSHATI JEZULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË
AUTORITETI KONTRAKTOR: BASHKIA MIRDITË



Nr	Nr. An (Manuali)	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI (lekë)	VLERA (lekë)
		L _{totale} =1'513m. Dega kryesore: L _{totale} =608m, L ₁ =310m me B ₁ =5.0m dhe B _{1asf} =4.0m dhe L ₂ =298m me B ₂ =4.5m e B _{2asf} =3.5m. Dega kodër Jezull L _{totale} =905m me B=4.0m dhe B _{asf} =3.0m				
1	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet (për kanale, bankinë e kasonetë)	m ³	498.50	-	-
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	498.50	-	-
3	3.164/1b	Mbushje me çakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (në trup rruge për nivelim me t _{mes} =25cm)	m ³	1,488.96	-	-
4	3.207/1	Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	6,231.20	-	-
5	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m ²	6,231.20	-	-
6	3.229/2	Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makinen	m ²	4,776.60	-	-
7	3.233/1	Shtrese asfallobetoni me zall lavatrice, 4cm, me makineri	m ²	4,776.60	-	-
8	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 (kuneta e ngritje portal)	m ³	33.60	-	-
9	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm, bankina	m ²	1,174.60	-	-
10	3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	2,909.20	-	-
			1	SHUMA	-	-
			2	FOND REZERVË 2%	-	-
			3	SHUMA PA TVSH	-	-
			4	TVSH 20%	-	-
			5	SHUMA TOTALE	-	-

Ky preventiv bazohet në manualin e çmimeve të marrë nga e-albania (miratuar me VKM-në Nr. 216, datë 13.04.2023).
HARTUAR NË DATËN 31.05.2024.

III.2.3. Në procesverbalin e datës 05.07.2024 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. ”.

III.2.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “AEK MUNELLA” ShPK autoriteti kontraktor në vendimin nr. 30, datë 29.07.2024, të komisionit të shqyrtimit të ankesës drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim: “... Në lidhje me këtë kërkesë **nuk** pranohet ankimi i OE pasi Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukturë transporti) është i domosdoshëm dhe i lidhur ngushtë me realizimin e punimeve, pasi kemi të bëjmë me ndërtim infrastrukture transporti (RRUGË).”.

III.2.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.6. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.2.7. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të

përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.8. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura,

për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.2.10. Autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të pikës 2.3.4 të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomik ofertues të disponojnë në stafin e tyre 1 (një) *Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukturë transporti)*.

Vendosjen e kësaj kërkesë për kualifikim autoriteti kontraktor e ka argumentuar, duke u bazuar në parashikimet e Neni 77 Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, nenit 39, pika 6, gërma “c” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, si dhe ka hartuar këtë kërkesë duke u shprehur se: “... me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. ”.

Nga shqyrtimi i pretendimit të ankimuesit për këtë kriter kualifikues, Komisioni gjykon se ankimuesi në pretendimin e tij nuk parashtron prova dhe fakte së përse ky kriter kualifikues është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, ndërkohë që referuar objektit të prokurimit, bazës ligjore, preventivit të punimeve dhe argumentimit të autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.4 të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit është një kërkesë që i shërben dhe është në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*AEK MUNELLA*” ShPK ku kërkon: “*KËRKESA 5*”

2.4 *Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim*

2.4.1 *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- *ISO 9001:2015* *Sistemet e Menazhimit të Cilësisë*
- *ISO 14001:2015* *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- *ISO 45001: 2018* *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve

Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Liçencë lëshuar nga QKL me kod III-2-B "Për grumbullim dhe transportim mbetjesh jo të rrezikshme".

Kjo kërkesë është në kalim të çdo llojë kompetence që mund t'i japë ligji për caktuar kriteret për të kryer një punë publike.

Liçencë leëshuar nga QKL me kod III-2-B "Për grumbullim dhe transportim mbetjesh jo të rreziksime" kjo licenëse i jepet kompanive të cilat kanë në pronësi ose qera një ambjent i cili është i përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve dhe nuk ka si të kërkohet për kompanitë që kryejnë procese ndërtimore. Mund të ishte kërkuar një marrëveshje për mbeturinat që datin nga objekti të dergohet në pikën më të afërt.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 **"FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT"** **"Kriteret e veçanta të kualifikimit"**, pika 2.4.1 **"Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim"**, të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

"2.4.1 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 *Sistemet e Menazhimit të Cilësisë*
- ISO 14001:2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*
- ISO 45001: 2018 *Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

Të gjitha certifikatat e mësiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë."

III.3.2. Në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) autoriteti kontraktor ka publikuar preventivin e zërave të punimeve objekt prokurimi si vijon:

PREVENTIVI

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION RRUGA FSHATI JEZULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË
AUTORITETI KONTRAKTOR: BASHKIA MIRDITË



Nr	Nr. An (Manuali)	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI (lekë)	VLERA (lekë)
		L _{totale} =1'513m. Dega kryesore: L _{totale} =608m, L ₁ =310m me B ₁ =5.0m dhe B _{1asf} =4.0m dhe L ₂ =298m me B ₂ =4.5m e B _{2asf} =3.5m. Dega kodër Jezull L _{totale} =905m me B=4.0m dhe B _{asf} =3.0m				
1	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet (për kanale, bankinë e kasonetë)	m ³	498.50	-	-
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	498.50	-	-
3	3.164/1b	Mbushje me çakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (në trup rruge për nivelim me t _{mes} =25cm)	m ³	1,488.96	-	-
4	3.207/1	Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	6,231.20	-	-
5	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m ²	6,231.20	-	-
6	3.229/2	Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makinen	m ²	4,776.60	-	-
7	3.233/1	Shtrese asfallobetoni me zall lavatrice, 4cm, me makineri	m ²	4,776.60	-	-
8	3.244/1	Struktura te holla monolite betoni C 20/25 (kuneta e ngritje portal)	m ³	33.60	-	-
9	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm, bankina	m ²	1,174.60	-	-
10	3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	2,909.20	-	-
			1	SHUMA	-	-
			2	FOND REZERVË 2%	-	-
			3	SHUMA PA TVSH	-	-
			4	TVSH 20%	-	-
			5	SHUMA TOTALE	-	-

Ky preventiv bazohet në manualin e çmimeve të marrë nga e-albania (miratuar me VKM-në Nr. 216, datë 13.04.2023).
HARTUAR NË DATËN 31.05.2024.

III.3.3. Në procesverbalin e datës 05.07.2024 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“**Argumentimi:** Per Liçence leshuar nga QKL me kod III-2-B“Per grumbullim dhe transportim mbetjesh jo te rrezikshme” Per inertet, mbetjet e dherave e inerteve qe do transportohen. Bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.”.

III.3.4. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “AEK MUNELLA” ShPK autoriteti kontraktor në vendimin nr. 30, datë 29.07.2024, të komisionit të shqyrtimit të ankesës drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim: “... Në lidhje me këtë kërkesë nuk pranohet ankimi i OE, pasi Për Licencë leshuar nga QKL me kod III-2-B“Për grumbullim dhe transportim mbetjesh jo të rrezikshme ” Për inertet, mbetjet e dherave e inerteve që do transportohen. Bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011

“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullitne të tjera nënligjore të përbashkëta”. Në preventivin e ofertës kemi zërin Transport dheu me auto mbi 5km dhe kjo licencë nevojitet për realizimin e punimeve për këtë zë punimesh.”.

III.3.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.3.6. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.7. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.8. Në nenin 39, pika 6, pika 7 dhe pika 8 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon, që:

- a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
 - ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

III.3.9. Në nenin 25 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar parashikohet:

- “1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.
2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.
4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.
5. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.”

III.3.10. Në nenin 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar parashikohet:

Neni 21

Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve

1. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.
2. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kushtet e përgjegjësisë dhe specifikon se në cilat raste krijuesi fillestar mban përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit dhe në cilat raste përgjegjësia ndahet mes tij dhe zotëruesit të mbetjeve apo u delegohet aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rrethanat në të cilat përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve mbartet, plotësisht apo pjesërisht, nga prodhuesi i produktit që krijon mbetjet dhe rrethanat kur këto përgjegjësi mund të ndahen me shpërndarësit e këtij produkti.
5. Personat fizikë a juridikë, të licencuar, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje, dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impiante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e këtij ligji.
6. Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen në baza profesionale nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm edhe në formë elektronike.
7. Dokumenti i transferimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
- a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
 - b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transferuesit;
 - c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të personit, tek i cili transferohet mbetja (pritësi);
 - ç) informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen dhe tipin e konteinerëve në të cilët ndodhet;
 - d) vendin, kohën dhe datën e transferimit;
 - dh) përshkrimin e mbetjeve jo të rrezikshme bashkë me listën e kodeve respektive;
 - e) hollësi për trajtimet apo procese të tjera që mbetjet jo të rrezikshme kanë pësuar deri në këtë çast.
8. I njëjti dokument transferimi lejohet të mbulojë më shumë se një transfertë mbetjesh jo të rrezikshme nga transferuesi tek i njëjti pritës vetëm nëse mbetjet që transferohen janë të ngjashme. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm për një periudhë kohe jo më të gjatë se 1 vit.
9. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i ruajnë dokumentet e transferimit për një periudhë kohe prej të paktën 2 vjetësh, të cilat ua vënë në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit për Mjedisin, pas paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim. Dokumentet përmbajnë minimalisht përshkrimin me shkrim të mbetjeve dhe kopjet e dokumenteve të transferimit.
10. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme.
11. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe kërkesa të tjera për informacionin që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

Neni 37

Mbetjet inerte

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kërkesat për menaxhimin e mbetjeve inerte.

Neni 57

Transportuesit e mbetjeve

1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve.
2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të

Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

III.3.11. Në Seksionin “KATEGORIA III.2 SHËRBIME EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE LIDHUR ME NDIKIMIN NË MJEDIS” të VKM nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar parashikohet:

KATEGORIA III.2

SHËRBIME EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE LIDHUR ME NDIKIMIN NË MJEDIS I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria e “shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” është kategoria III.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) shfuqizuar;

b) “veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.B.

3. Licencat e kategorisë III.2 jepen pa afat kohor.

III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.B

8. Licencat për nënkategorinë III.2.B jepen për çdo vend ku kryhet veprimtaria.

9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

10. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për kategorinë III.2.B, përcaktohen në tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe e eksperiencës së personelit	Drejtuksi teknik. (funksioni me kohë të plotë sipas veprimtarisë specifike)	a) Diplomë ose certifikatë për drejtuesin teknik; b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës;
Përshtatshmëria e pajisjeve , teknologjisë dhe mjediseve me standartet e shërbimit specifik	a) Mjedisi; b) Teknologjia; (sipas veprimtarisë specifike)	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe dokumente që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve

11. Licencimi i nënkategorisë III.2.B bëhet sipas procedurës së grupit III.

a) Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kriterëve të licencimit për nënkategorinë III.2.B është struktura e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, e caktuar me udhëzim të ministrit, sipas kompetencës territoriale në vendin ku ushtrohet veprimtaria. Vendimi bazohet në dokumentet provuese dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve përkatëse të licencimit.

b) Afati i marrjes së vendimit është 30 ditë.

IV. DATA E FILLIMIT TË LICENCIMIT SIPAS KËTIJ VENDIMI

12. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.

III.3.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.3.13. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik, e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta (inerte), gjatë kryerjes së veprimtarisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar preventivit të punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve si: *“Transport materiale dheu me auto deri 5.0 km”*.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 *“Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, parashikohet se *“Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”* Sa më sipër, KPP gjykon se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet nevoja e prishjeve të mureve dhe soletave, heqja e dyerve dhe dritareve në volume të konsiderueshme, si edhe më pas transportimi i tyre. Sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është në përputhje me natyrën dhe volumen e kontratës, pasi krahas punimeve të prishjeve, operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e

mbeteve urbane, transport, i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e Licencës të lëshuar nga QKL për grumbullimin, transportim, ruajtje, e mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B), Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik, e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe grumbullimi transporti i mbetjeve të ngrurta (inerte dhe dherave) mbetje këto të cilat do të dalin kryesisht si rezultat i kryerjes së punimeve për realizimin e kontratës, gjatë kryerjes së veprimtarisë. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve për transport dheu me kamion deri në 5 (pesë) kilometra. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”

Sa më sipër, KPP gjykon se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventiviti, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë së largimit dhe transportimit të mbetjeve inerte, ndaj kërkesa . Por, autoriteti kontraktor ka kërkuar licencën e gabuar në dokumentat e tenderit, pasi gjatë zbatimit të kontratës nuk është parashikuar grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, në kuptim të ligjit nr.8094 datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”. Komisioni thekson se kërkesa joproporcionale mund të përbëjë shkak për skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë në fazën e vlersimit të ofertave. Ndaj në këtë kuptim, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit, duke kërkuar paraqitjen e Licensës me Kodin III.2.B në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “AEK MUNELLA” ShPK ku kërkon:
“KËRKESA 6

2.4.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se nuk ka asnjë detyrim ndaj Bashkisë Mirditë dhe as dëm ekonomik të pashlyer të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Asnjë operator ekonomik nuk do të shpallet fitues nëse ka detyrime, apo dëm ekonomik të lënë nga KLSH-ja, të pashlyer ndaj Bashkisë Mirditë. Kjo është një formë që Bashkia Mirditë zgjedh për të plotësuar rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.

Me sa duket me këtë kërkesë Autoriteti Kontraktor bën parashikimi se kush duhet të fitoj dhe kush nuk duhet ta fitoj objektin e prokurimit.

Ky kriter është në kundërshtim me LPP dhe VKM. Format e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së janë të qarta në legjislacionin shqiptarë më saktë janë të rregulluar me LIGJ Nr. 154/2014

"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të lartë të Shtetit" dhe jo nga mendimet e Qeverisjes Vendore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është mjete i cili rregullon të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 *"FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT"* *"Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.4.4 "Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim", të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:*

*"2.4.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se nuk ka asnjë detyrim ndaj bashkisë Mirditë dhe as dëm ekonomik të pashlyer të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Asnjë operator ekonomik nuk do të shpallet fitues nëse ka detyrime, apo dëm ekonomik të lënë nga KLSH-ja, të pashlyer ndaj bashkisë Mirditë. Kjo është një formë që bashkia Mirditë zgjedh për të plotësuar rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

III.4.2. Në procesverbalin e datës 05.07.2024 *"PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM"* të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

III.4.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues *"AEK MUNELLA"* ShPK autoriteti kontraktor në vendimin nr. 30, datë 29.07.2024, të komisionit të shqyrtimit të ankesës drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim: *"... Në lidhje me këtë kërkesë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nuk pranon ankimin e OE, pasi, siç edhe citohet, kjo është një formë shtrënguese që Bashkia Mirditë zgjedh për të plotësuar rekomandimet e lëna nga KLSH-ja të cilat na kanë ardhur me shkresë zyrtare dhe e kemi detyrim ligjor për ti plotësuar. Vlen të theksohet se ky kriter është për të gjithë ata operator që dëshirojnë të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik në Bashkinë Mirditë të cilat nuk duhet të kenë detyrime ndaj saj si dëm ekonomik të lënë nga KLSH-ja."*

III.4.4. Në Nenin 2 *"Qëllimi"* të ligjit 162/2021 *"Për prokurimin publik"*, i ndryshuar parashikohet se:

"Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.4.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.4.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale.
 Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.4.7. Në Nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”.

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.3.13. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.4.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit lidhur me paraqitjen nga ana e ofertuesve të një deklaratë ku të shprehet se nuk ka asnjë detyrim ndaj Bashkisë Mirditë dhe as dëm ekonomik të pashlyer të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është një kriter i vendosur në tejkalim të kontratës objekt prokurimi, duke kërkuar dokumente që janë përtej objektit të kontratës dhe që kufizojnë gjithashtu konkurrencën, si dhe nuk është e mbështetur në legjislacionin e prokurimit publik, duke qënë në kundërshtim me nenet 2, 3, 21 dhe 77, të LPP-së dhe rregullat e prokurimit publik. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat, për të hequr kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.4.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “AEK MUNELLA” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*AEK MUNELLA*” ShPK për procedurën e prokurimit “*AEK MUNELLA*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-12492-07-09-2024, me objekt “*Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite*”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*AEK MUNELLA*” ShPK për procedurën e prokurimit “*AEK MUNELLA*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-12492-07-09-2024, me objekt “*Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite*”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*AEK MUNELLA*” ShPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

